

URDHËR
Nr. 179, datë 19.11.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ

1. Delegimin e kompetencës së ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Besjan Kadiu, për nënshkrimin e:

- a) aktit të miratimit ose të refuzimit të lejes së kërkim, zbulim dhe shfrytëzimit për aplikimet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për t’u pajisur me leje minerare;
- b) njoftimit për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare;
- c) njoftimit për ndërprerjen e procedurave të fillimit të revokimit të lejeve minerare;
- ç) vendimit për revokimin e lejeve minerare;
- d) aktit për pasqyrimin dhe miratimin e ndryshimeve të të dhënave në lejet minerare;
- dh) aktit të miratimit ose të refuzimit të lejes së kërkim, zbulim dhe shfrytëzimit për zgjatjen e afateve, ndryshimin e koordinatave, transferimin e lejeve minerare;
- e) aktit të dhënies së të drejtës së aplikimit në QKB, për zonat e hapura për qëllime publike;
- ë) aktit për miratimin e nënkontraktimeve;
- f) shkresës së korrespondencës me QKB për sektorin minerar;
- g) miratimit dhe refuzimit të aplikimeve për autorizimet për personat juridikë privatë ose publikë, vendës apo të huaj, për përdorim civil të lëndëve plasëse.
- gj) urdhrit për kthimin apo moskthimin e garancive financiare të rehabilitimit dhe investimit;
- h) urdhrit për miratimin e projekteve shtesë të veprimtarive minerare.

2. Në ushtrimin e kompetencave të deleguara, sipas pikës 1, të këtij urdhri, zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë z. Besjan Kadiu, i ndjek dhe i zbaton ato në mbështetje të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij dhe ligjit nr. 74/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, brenda fushës së përgjegjësisë së përcaktuar në këtë urdhër.

3. Kompetencat e deleguara sipas pikës 1 ushtrohen nga data e hyrjes në fuqi e këtij urdhri deri në miratimin e një urdhri të dytë.

4. Urdhri nr. 121, datë 1.9.2025, i zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Besjan Kadiu, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Belina Balluku